

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I  
Z Y R T A R

---

vëllimi 27 numër 2 maj 2025

Data e botimit: 22.5.2025



P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.16, datë 26.3.2025  
"Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.17, datë 26.3.2025  
"Për miratimin e "Pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2024"" 7
3. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.1456, datë 28.03.2025  
"Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit" 8
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.20, datë 2.4.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Mbikëqyrjes"" 10
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.22, datë 2.4.2025  
"Për disa ndryshime në rregulloren "Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit"" 16
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.24, datë 7.5.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 18
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.25, datë 7.5.2025 "Për vendosjen e kufijve të sipërm për treguesit "Raporti i kredisë ndaj vlerës" dhe "Raporti i shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave" për kreditë që japin bankat për pasuri të paluajtshme rezidenciale" 20
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.26, datë 7.5.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor"" 23
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.27, datë 7.5.2025 "Për rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, me prerje 2000 Lekë" 25
9. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 1, mars 2025 26





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 16, datë 26.3.2025

**PËR**  
**MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË**  
**MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE**  
**TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË**  
**NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.75 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.75 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.75 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 17, datë 26.3.2025

**PËR  
MIRATIMIN E  
“PASQYRAVE FINANCIARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2024”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “l” dhe të nenit 69, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë “Pasqyrat Financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2024”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Pasqyrat financiare të miratuara sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe opinionit i audituesit të jashtëm, janë pjesë përbërëse e Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2024.
3. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Politikës Monetare.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**GUVERNATORI**

Nr. 1456 prot.

Tiranë, më 28.03.2025

**VENDIM**  
Nr.1456, datë 28.03.2025

**PËR**  
**CAKTIMIN E SHITESAVE MAKROPRUDENCIALE TË KAPITALIT**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 11, 12, 14 dhe nenit 16, pika 1, shkronja "ç" dhe "d", të rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

**VENDOSA:**

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë mbetet 0.5 për qind, dhe do të përmbushet duke filluar nga data 31 mars 2026.
2. Bankat me rëndësi sistemike (BARS) dhe shtesat përkatëse të kapitalit (SIST), përcaktohen si me poshtë:

BARS	Vlerësimi për SIST-in total	SIST-i për periudhën 1 janar – 31 dhjetor, 2026 (përveç kur përcaktohet ndryshe)
Banka Kombëtare Tregtare sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind (në datën e parë të punës që pason shpalljen e këtij vendimi)
Banka Credins sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka Raiffeisen sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka Intesa SanPaolo Albania sh.a.	0.5 për qind	0.5 për qind

3. Shtesat makroprudenciale të kapitalit sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, zbatohen së bashku me shtesën konservuese të kapitalit (KONS) sipas tabelës 2, të nenit 10, pika 1, të rregullores 41/2019, ku vlera e KONS-it në vijimësi është në nivelin 2.5 për qind.
4. Shtesat makroprudenciale të kapitalit, sipas pikës 3 të këtij vendimi, zbatohen dhe mbahen në nivel institucioni të veçantë (solo basis).
5. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
6. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**GUVERNATOR**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 20, datë 2.4.2025

**PËR**  
**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN**  
**“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DEPARTAMENTIT TË**  
**MBIKËQYRJES”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “f” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 14, pika 1 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 90, datë 2.12.2015; të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 31.10.2005 “Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Mbikëqyrjes”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 44, datë 30.3.2016, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 4, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

*“Sektori i Mbikëqyrjes së Rreziqeve, përbëhet nga:*

- a) *Zyra e Mbikëqyrjes së Rrezikut të Kredisë;*
- b) *Zyra e Mbikëqyrjes së Rrezikut të Likuiditetit dhe Rreziqeve të Tregut;*
- c) *Zyra e Mbikëqyrjes së Rrezikut Operacional;*
- d) *Zyra e Mbikëqyrjes së Rrezikut Reputacional; dhe*
- e) *Zyra e Mbikëqyrjes së Rrezikut për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”.*

b) Në nenin 6, pika 5, togfjalëshi "Përgjegjësi i Zyrës së Mbikëqyrjes së Rreziqeve të Tregut dhe Likuiditetit," zëvendësohet me togfjalëshin "Përgjegjësi i Zyrës së Mbikëqyrjes së Rrezikut të Likuiditetit dhe Rreziqeve të Tregut," si dhe pas togfjalëshit "Përgjegjësi i Zyrës për Mbikëqyrjen e Rrezikut Operacional," shtohet togfjalëshi "Përgjegjësi i Zyrës për Mbikëqyrjen e Rrezikut për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit";

c) Neni 8, pika 2 ndryshohet si më poshtë;

*"Sektori i Mbikëqyrjes së Rreziqeve ka në përbërjen e tij:*

- i. Zyrën e Mbikëqyrjes së Rrezikut të Kredisë;*
- ii. Zyrën e Mbikëqyrjes së Rrezikut të Likuiditetit dhe Rreziqeve të Tregut;*
- iii. Zyrën e Mbikëqyrjes së Rrezikut Operacional;*
- iv. Zyrën e Mbikëqyrjes së Rrezikut Reputacional; dhe*
- v. Zyrën e Mbikëqyrjes së Rrezikut për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit".*

d) Në nenin 8, pika 4, shkronja "a", togfjalëshi "si edhe rrezikut operacional," zëvendësohet me togfjalëshin "reputacional, si dhe rrezikun operacional," si dhe pas togfjalëshit "parandalimit të pastrimit të parave", shtohet togfjalëshi "dhe financimit të terrorizmit";

e) Në nenin 8, pika 7, pas togfjalëshit "dhe për çdo bankë", shtohet togfjalëshi "ose subjekt financiar";

f) Në nenin 10, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- i. titulli i nenit zëvendësohet me "Funksionet dhe detyrat e Zyrës së Mbikëqyrjes së Rrezikut të Likuiditetit dhe Rreziqeve të Tregut",*
- ii. në pikën 1, togfjalëshi "Zyra e Mbikëqyrjes së Rreziqeve të Tregut dhe Likuiditetit," zëvendësohet me togfjalëshin "Zyra e Mbikëqyrjes së Rrezikut të Likuiditetit dhe Rreziqeve të Tregut,"*
- iii. në pikën 1, shkronja "g", pas togfjalëshit "dhe për çdo bankë", shtohet togfjalëshi "ose subjekt financiar";*

g) Në nenin 11, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- i. në pikën 1, shkronja "e", pas togfjalëshit "apo edhe grup bankash", shtohet togfjalëshi "ose subjektsh financiare",*
- ii. në pikën 1, shkronja "h", pas togfjalëshit "dhe për çdo bankë", shtohet togfjalëshi "ose subjekt financiar";*

h) Përmbajtja e nenit 12 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

## **“Neni 12 Funksionet dhe detyrat e Zyrës së Mbikëqyrjes së Rrezikut Reputacional**

1. Zyra e Mbikëqyrjes së Rrezikut Reputacional, në përmbushje të detyrave funksionale të Sektorit të Mbikëqyrjes së Rreziqeve të përcaktuara më sipër, kryen këto detyra
  - a) merr pjesë në procesin e inspektimit në vend për të vlerësuar rrezikun reputacional dhe transparencën për një subjekt të caktuar apo grup subjektesh;
  - b) në përputhje me gjetjet nga procesi i inspektimit, kryen vlerësimet përkatëse cilësore dhe sasiore sipas metodologjisë së vlerësimit të rreziqeve dhe përgatit raportin përkatës;
  - c) inicion dhe drejton inspektime horizontale në vend për të vlerësuar rrezikun reputacional në tërësi apo aspekte të veçanta të tij, si dhe transparencën për disa banka ose subjekte financiare. Në koordinim me Përgjegjësën e Sektorit:
    - paraqet në kohë sa më të shpejtë rezultatet e inspektimit të Sektorit i Mbikëqyrjes së Subjekteve Individuale;
    - koordinon rekomandimet dhe masat e propozuara me Sektorin e Mbikëqyrjes së Subjekteve Individuale, nëse ka të tilla;
    - ndjek në vazhdimësi me Sektorin e Mbikëqyrjes së Subjekteve Individuale mjaftueshmërinë e zbatimit të rekomandimeve dhe masave të marra, nëse ka të tilla;
  - d) verifikon saktësinë e të dhënave të publikuara prej subjekteve dhe në bashkëpunim me sektorët e tjerë, vlerëson shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga klientët e subjekteve/bankave;
  - e) monitoron në mënyrë të vazhdueshme, përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative të Bankës së Shqipërisë lidhur me transparencën e shërbimeve dhe produkteve bankare dhe financiare, në nivel sistemi/grupi bankash/banke individuale ose subjektesh financiare;
  - f) mban marrëdhënie me autoritetet e tjera monitoruese dhe rregulluese për transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorit;
  - g) kryen analiza periodike nga jashtë për rrezikun reputacional në nivel sistemi. Vlerësimi i rrezikut reputacional kryhet nëpërmjet të dhënave nga raportimet periodike apo raportimet ad-hoc, si dhe informacionit të marrë nga sektorë të tjerë të Departamentit të Mbikëqyrjes;

- h) kryen analiza të veçanta dhe të thelluara nga jashtë për rrezikun reputacional, në nivel sistemi apo grup bankash ose subjektsh financiare, si rrjedhojë e ndryshimeve në infrastrukturën ligjore dhe rregullative apo sinjaleve për rritje të ekspozimit ndaj rrezikut reputacional. Vlerësimi i rrezikut reputacional mund të mbështetet në të dhënat periodike të raportuara apo raportime specifike sipas situatës;
- i) propozon ndryshime apo përmirësime të kuadrit rregullator dhe metodikave në lidhje me vlerësimin e rrezikut reputacional dhe çështje të transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit, në funksion të monitorimit sa më efikas të rrezikut reputacional në nivel sistemi dhe forcimit të disiplinës në treg;
- j) administron të dhënat e subjekteve financiare për qëllime të analizave dhe monitorimit të rrezikut reputacional në tërësi apo aspekte të veçanta të tij për disa subjekte/banka;
- k) raporton periodikisht tek Përgjegjësi i Sektorit të Mbikëqyrjes së Rreziqeve.”;
- i) Pas nenit 12, shtohet neni 12/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

#### **“Neni 12/1**

#### **Funksionet dhe detyrat e Zyrës së Mbikëqyrjes së Rrezikut për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit**

1. Zyra e Mbikëqyrjes së Rrezikut për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, në përmbushje të detyrave funksionale të Sektorit të Mbikëqyrjes së Rreziqeve të përcaktuara më sipër, kryen këto detyra:
- a) merr pjesë në procesin e inspektimit në vend për të vlerësuar rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për një subjekt të caktuar apo grup subjektsh;
- b) në përputhje me gjetjet nga procesi i inspektimit kryen vlerësimet përkatëse cilësore dhe sasiore sipas metodologjisë së vlerësimit të rreziqeve dhe përgatit raportin përkatës;
- c) inicion dhe drejton inspektime horizontale në vend për të vlerësuar rrezikun dhe çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për disa banka ose subjekte financiare. Në koordinim me Përgjegjësin e Sektorit:
- paraqet në kohë sa më të shpejtë rezultatet e inspektimit të Sektorit të Mbikëqyrjes së Subjekteve Individuale,
  - koordinon rekomandimet dhe masat e propozuara me Sektorin e Mbikëqyrjes së Subjekteve Individuale, nëse ka të tilla,

- ndjek në vazhdimësi me Sektorin e Mbikëqyrjes së Subjekteve Individuale mjaftueshmërinë e zbatimit të rekomandimeve dhe masave të marra, nëse ka të tilla;
- d) monitoron në mënyrë të vazhdueshme, përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në nivel sistemi/grupi bankash/banke individuale ose subjektesh financiare;
- e) mban korrespondencën me Autoritetin Përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe koordinon bashkëpunimin me të në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta, përfaqësimit të Shqipërisë përpara organizmave ndërkombëtare, hartimit dhe zbatimit të strategjive kombëtare për këtë qëllim etj.;
- f) propozon ndryshime apo përmirësime të kuadrit rregullator dhe metodikave në lidhje me vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në funksion të monitorimit sa më efikas të këtij rreziku;
- g) administron të dhënat e subjekteve financiare për qëllime të analizave dhe monitorimit të rrezikut për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- h) raporton periodikisht tek Përgjegjësi i Sektorit të Mbikëqyrjes së Rreziqeve.”;
- j) Në nenin 20, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - i. në pikën 1, përmbajtja e shkronjës “a” ndryshon si vijon:  
“a) harton projekte të rregulloreve dhe të udhëzimeve që lidhen me funksionin licencues dhe mbikëqyrës të veprimtarisë së subjekteve të licencuara, në përputhje me direktivat dhe rregulloret evropiane, me standardet ndërkombëtare për një mbikëqyrje efektive, si dhe me praktikat më të mira në fushën e mbikëqyrjes bankare;”;
  - ii. në pikën 1, shkronja “b”, pas togfjalëshit “të direktivave”, shtohet togfjalëshi “dhe rregulloreve”;
- k) Në nenin 23, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - i. në pikën 1, shkronja “e”, togfjalëshi “informon Guvernatorin”, zëvendësohet me togfjalëshin “informon Administratorin Përgjegjës dhe Guvernatorin”,
  - ii. në pikën 1, shkronja “f”, togfjalëshi “Informon Guvernatorin/ Administratorët e tjerë”, zëvendësohet me togfjalëshin “informon Administratorët”;

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 22, datë 2.4.2025

**PËR**  
**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN**  
**“PËR NXJERRJEN E VLERAVE MATERIALE JASHTË PËRDORIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat “c”, “f” dhe “g” dhe nenit 53, pika 4 me propozim të Guvernatorit, Departamentit të Administrimit dhe Departamentit të Sigurimit dhe Mbrojtjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 117, datë 9.11.2016, e ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - 1.1 Pas nenit 3, shtohet neni 3/1 “Përjashtimet” me përmbajtje si vijon:

**“Neni 3/1**  
**Përjashtimet**

1. *Përjashtim nga përcaktimet e kësaj rregulloreje bëjnë nxjerrja jashtë përdorimit e pajisjeve TIK, të cilat ruajnë, përpunojnë ose transmetojnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”.*
  2. *Rregullat për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe shkatërrimit të pajisjeve TIK, të cilat ruajnë, përpunojnë ose transmetojnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, rregullohen me akt të veçantë të Guvernatorit referuar legjislacionit përkatës.”*
- 1.2 Në nenin 11, në pikat 11.2, 11.3 dhe 11.4, fjala “Guvernator” zëvendësohet me “Zëvendësguvernator i Parë”.
  - 1.3 Në nenin 11, shtohet pika 11.4/1 dhe 11.4/2, me përmbajtje si më poshtë:

*"11.4/1 Njoftimi i fituesit dhe anulimi i procedurës (jo në rastet e ankimeve), sipas përcaktimeve në ligjin "Për ankandin publik" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, miratohet nga Zëvendësguvernatori i Parë.*

*11.4/2 Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të ankandit, kur gjykon se një vendim i autoritetit shitës është marrë në kundërshtim me ligjin "Për ankandin publik" apo me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.*

*Ankimi i paraqitet me shkrim Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Shqyrtimi bëhet sipas procedurave të parashikuara në ligjin "Për ankandin publik" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij."*

2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
3. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 24, datë 7.5.2025

**PËR  
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË  
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE  
TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË  
NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.75 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.75 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.75 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 25, datë 7.5.2025

**PËR  
VENDOSJEN E KUFIJVE TË SIPËRM PËR TREGUESIT "RAPORTI I  
KREDISË NDAJ VLERËS" DHE "RAPORTI I SHËRBIMIT TË BORXHIT NDAJ  
TË ARDHURAVE" PËR KREDITË QË JAPIN BANKAT PËR PASURI TË  
PALUAJTSHME REZIDENCIALE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; dhe të rregullores nr. 44, datë 4.10.2023 "Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet për prona të paluajtshme", neni 4, neni 13, neni 14, pika 1, shkronjat "b" dhe "c", dhe pika 2, neni 15, pika 1, shkronja "a" dhe pika 2, dhe neni 16; me propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar të Bankës së Shqipërisë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Për kredinë e re për pasuri të paluajtshme rezidenciale që japin bankat:
  - a) të miratojë vendosjen e kufijve të sipërm për treguesin "raporti i kredisë ndaj vlerës, në disbursim" (HnV\_D), si më poshtë:
    - i. në Lek, HnV\_D të mos kapërcejë vlerën 85 për qind,
    - ii. në Lek, për blerjen e një shtëpie të dytë (dhe vijuese) ose për t'u dhënë me qira, HnV\_D të mos kapërcejë vlerën 80 për qind,
    - iii. në valutë, HnV\_D të mos kapërcejë vlerën 75 për qind,
    - iv. në valutë, për blerjen e një shtëpie të dytë (dhe vijuese) ose për t'u dhënë me qira, HnV\_D të mos kapërcejë vlerën 70 për qind;
  - b) të miratojë vendosjen e kufijve të sipërm për treguesin "raporti i shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave, në disbursim" (ShBnA\_D), si më poshtë:

- i. në Lek, ShBnA\_D të mos kapërcejë vlerën 40 për qind,
  - ii. në Lek, për blerjen e një shtëpie të dytë (dhe vijuese) ose për t'u dhënë me qira, ShBnA\_D të mos kapërcejë vlerën 35 për qind,
  - iii. në valutë, ShBnA\_D të mos kapërcejë vlerën 35 për qind,
  - iv. në valutë, për blerjen e një shtëpie të dytë (dhe vijuese) ose për t'u dhënë me qira, ShBnA\_D të mos kapërcejë vlerën 30 për qind,
  - v. për përcaktimin e vlerës së borxhit të kredimarrësit, krahas vlerës së kredisë konkrete (dhe të kredive të tjera që ai mund të ketë në sistemin financiar), banka do të përfshijë edhe çdo borxh tjetër të tij për të cilin banka ka siguruar informacion të besueshëm nga komunikimi me kredimarrësin apo konsultimi paraprak i bazave relevante të të dhënave;
- c) të lejojë bankat që të zbatojnë kuota përjashtimi nga kufizimet e mësipërme në secilin prej treguesve HnV\_D dhe ShBnA, me kushtin që, në total, vlera e kredive të përjashtuara të mos kapërcejë 15 për qind të vëllimit të kredive të reja që janë miratuar dhe disbursuar (edhe pjesërisht) gjatë tremujorit. Në këtë kuotë përjashtimi do të përfshihen lehtësitë e rifinancimit që jepen gjatë tremujorit për kreditë ekzistuese dhe që mund të kapërcejnë kufirin e treguesit. Bankat duhet t'i identifikojnë kreditë dhe lehtësitë e rifinancimit që përfshihen në kuotën e përjashtimit, në mënyrë individuale dhe t'i evidentojnë ato në mënyrë të dallueshme në raportimin tremujor që kryejnë pranë Bankës së Shqipërisë;
- d) të përjashtojë nga përfshirja në llogaritjen e kufizimeve sipas shkronjave "a", "b" dhe "c" më sipër:
- i. kreditë që disbursohen në kuadër të skemave që mbështesin politikatat publike të strehimit,
  - ii. kreditë që disbursohen për rinovimet e banesave që lidhen me përmirësimin e efikasitetit të energjisë apo kalimin drejt burimeve të energjisë së rinovueshme, deri në vlerën 3 milionë lekë (ose kundërvlera përkatëse në valutë nëse disbursohen në valutë),
  - iii. disbursimin në kuadër të granteve të parikthyeshme publike që lidhen me përmirësimin e efikasitetit të energjisë apo kalimin drejt burimeve të energjisë së rinovueshme, tek banesat;
- e) të rekomandojë për bankat zbatimin e një kufiri maksimal në afatin e maturimit në disbursim të kredisë, pavarësisht monedhës, sa minimumi midis:
- i. 30 vjet,
  - ii. numri i viteve deri në arritjen e moshës së pensionit të kredimarrësit (ose të kredimarrësit që e arrin këtë moshë më shpejt në rastin e kredisë me bashkëkredimarrës).
2. Ky vendim fillon të zbatohet nga bankat për kreditë e reja për pasuri të paluajtshme rezidenciale që disbursohen nga data 1

korrik 2025.

3. Ky vendim rishqyrtohet jo më vonë se 2 vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi.
4. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar, Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
5. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM  
Nr. 26, datë 7.5.2025

**PËR**  
**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN**  
**“PËR SHTYPJEN, RISHTYPJEN, HEDHJEN DHE TËRHEQJEN NGA**  
**QARKULLIMI TË KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE METALIKE**  
**SHQIPTARE ME KURS LIGJOR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 33, pika 2, nenit 39, pika 2 dhe nenit 43, shkronjat “c” dhe “d” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Emissionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 133, datë 7.12.2016, e ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) në nenin 3, pika 2, germa “f”, togfjalëshi “viti shtypjeje” zëvendësohet me shprehjen “shtypjeje të miratuar sipas përcaktimeve të nenit 14 të kësaj rregulloreje”;
  - b) në nenin 13, pika 2, fjala “kartëmonedhave” zëvendësohet me togfjalëshin “kartëmonedhave ose monedhave metalike”;
  - c) në nenin 13, pika 4, fjala “kartëmonedhë/ave” zëvendësohet me togfjalëshin “kartëmonedhë/ave ose monedhë/ave metalike” sipas rastit;
  - d) në nenin 16, pika 4, pas togfjalëshit “natyrës gramatikore” shtohet shprehja “si dhe ndryshimi i vitit të shtypjes në rastin e rishtypjes së monedhave metalike”;
  - e) në nenin 16, pika 4, fjala “kartëmonedhës” zëvendësohet me togfjalëshin “kartëmonedhës ose monedhës metalike”;

- f) në nenin 17, pika 1, togfjalëshi "vit shtypjeje" zëvendësohet me togfjalëshin "shtypje të miratuar sipas përcaktimeve të nenit 14 të kësaj rregulloreje";
  - g) në nenin 19, shprehja "rregulloren "Mbi asgjësimin e kartëmonedhave, monedhave metalike shqiptare dhe bonove të privatizimit"" zëvendësohet me shprehjen "rregulloren "Mbi asgjësimin e kartëmonedhave, monedhave metalike, bonove të privatizimit dhe kategorive të tjera të lidhura"";
  - h) neni 21 shfuqizohet.
2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
  3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 27, datë 7.5.2025

**PËR  
RISHTYPJEN E KARTËMONEDHAVE SHQIPTARE ME KURS LIGJOR, ME  
PRERJE 2000 LEKË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 33 pikat 2 dhe 3, nenit 36, nenit 39 pika 2, dhe nenit 43, shkronja "c" dhe "d", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 14, të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin nr. 133, datë 7.12.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor me prerje 2000 Lekë në përputhje me përcaktimet e Aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Viti i shtypjes, i shfaqur në trupin e kartëmonedhave, të jetë viti 2020.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të Aneksit, që përmban informacion të klasifikuar jopublik "sekret bankar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**

## TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 1, MARS 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 3, datë 15.1.2025 për "Miratimin e Programit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri dhe dokumentacionit shoqërues"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 5.2.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 10, datë 5.2.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare""
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 11, datë 5.2.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare""
5. Vendim i Zëvendësguvernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 1072, datë 4.3.2025 për "Miratimin e politikës së administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 14, datë 5.3.2025 "Për kryerjen e pagesës së rritjes së kuotës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar"



